



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:284545  
Datë: 23.04.2024  
Numri i dokumentit: 05608797

**AC-I-23-0416**

***Në ankesën e***

***Paditësja/Ankuesja***

**Z I**, nga Prishtina, e përfaqësuar nga avokati **Sh S**, nga Prishtina.

**Kundër**

***E paditura***

**NSH. "Auto Prishtina"**, (në likuidim), Prishtinë, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-22-0465 të datës 04 korrik 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- 1. Ankesa e paditëses është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-22-0465 i datës 04 korrik 2023.**

### **3. Lënda kthehet në rigjykim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, tek gjyqtari përkatës.**

### **4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

#### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 29 prill 2015, paditësja e dorëzon një padi në DHPGJS për pagesën e pagave të mbetura e të pa paguara nga NSH "Auto Prishtina", në Prishtinë. Me këtë padi kërkohet nga Gjykata që të detyrohet e paditura të paguaj borxhin kryesor për paga të pa paguara për periudhën tetor 2003- qershor 2014, në shumë prej 10.140,00 euro, si dhe ka kërkuar kamatën ligjore në vlerë prej 3.5 % për çdo vit. Në këtë padi paditësja nuk cek ndonjë vendim të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në padi paditësja pohon se ajo vazhdimisht i ka kërkuar pagat nga NSH-ja e paditur në bazë të kontratës së punës dhe atë deri në fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-së për çka ajo pohon se e ka pranuar një Njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe mundësinë e paraqitjes së kërkesave tek Autoriteti i Likuidimit. Në padi ajo pohon se kishte rezistuar me punëtor të tjerë për uzurpimin e pronës së NSH-së, nga ana e ndërmarrjes private e cila e kishte marrë asetet e NSH-së, me qira, mirëpo as AKP-ja as menagjmenti i NSH-së, dhe as ndërmarrja nuk kanë siguruar funksionim normal të NSH-së, kështu që punëtorët nuk kishin mundësi të punonin pa pengesa për çka punëtorët nuk ndihen fajtor. Bashkë me këtë padi paditësja dorëzon autorizimin e avokatit, dokumentin e regjistrimit të NSH-së në ARBK, Njoftimi drejtuar Autoritetit të Likuidimit për dorëzimin e padisë në Gjykatë, një shkresë të AKM-së drejtuar Drejtorit të kompanisë "Auto Kosova", B S, e datës 18 nëntor 2004, një shkresë tjetër e AKM-së drejtuar drejtorit të "Auto Kosova", B S e datës 19 gusht 2004, një listë të punëtorëve aktiv të cilët nuk kanë marrë paga sipas kontratës së punës e dorëzuar në AKP me 12.09.2014, kontratën e punës të datës 10.10.2003, një deklaratë drejtuar zyrës rajonale të Prishtinës, fotokopjen e Librezës së punës e hapur me 31.12.1992, nuk është e mbyllur.

Me datë 03 tetor 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në padi. Në mbrojtjen në padi AKP-ja ka pohuar se padia nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë nga neni 70.2 i Shtojcës së LDHP. AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të tregoj se cili nen është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e

vendimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa e paditëses është parashkruar pasi që ajo nuk ka dorëzuar ndonjë dëshmi ti ketë kërkuar këto paga brenda 3 viteve e më së voni nga shtatori i vitit 2003, kur pretendohet se nuk janë paguar pagat nga NSH-ja. Tutje AKP-ja pohon se do ta bëjë me dije Gjykatën se në fakt asetet e ndërmarrjes janë lëshuar me qira për gjatë gjithë periudhës në të cilën paditësja i kërkon pagat. Ndërmarrja nuk ka kryer asnjë nga funksionet e kësaj bazë, por menagjmenti i vetë emëruar ka vjelë të ardhura nga qiradhënia e aseteve të NSH-së, ndërsa edhe lista e paraqitur me ankesë është përgatitur nga ky menagjment i vetë quajtur dhe atë e ka dorëzuar në momentin kur Bordi i AKP-së e morri në shqyrtim vendosjen e NSH-së në likuidim. Ajo listë thjeshtë ka vlerë deklarative dhe nuk mund të shërbej assesi si provë për përfitimin e pretenduar në këtë kërkesë.

Me datë 16 tetor 2017, paditësja e dorëzon një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në padi të AKP-së. Në këtë parashtresë ajo pohon se e kishte pranuar një Njoftim nga AKP se ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH "Auto Prishtina", me datë 21 korrik 2014, dhe se në bazë të këtij njoftimi thuhet se anulohet kontrata e punës deri atëherë në fuqi. Tutje paditësja pohon se ishte e punësuar në NSH në bazë të kontratës së punës dhe kjo kontratë ka qenë e plotfuqishme ndërsa NSH-ja ka qenë e obliguar të siguroj pagën mujore prej 163,83 euro në muaj si pastruese për 130 muaj të mbetura të pa paguara në periudhën e cekur. Në këtë parashtresë ajo pretendon se borxhi i mbetur është 10.140,00 euro. Në parashtresë i përsërit edhe pretendimet e tjera që i kishte cekur në ankesë. Bashkë me këtë parashtresë paditësja ka dorëzuar dëshmi të njëjta të dorëzuara edhe më herët por edhe një vendim të Autoritetit të Likuidimit PRN126-0138 datë 29.04.2015, i cili nuk ka të bëjë me kërkesën për paga, por ka të bëjë me kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës me ç`rast shihet se është pranuar një shumë prej 565,04 euro, dhe në emër të tatimit në shumë prej 59.71 euro, Njoftimin e AKP-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës në emër të një punëtori tjetër A H, një deklaratë dhe një informatë e kryetarit të sindikatës, si dhe një listë të punëtorëve të "Auto Prishtinës", një njoftim i kryetarit të Këshillit të punëtorëve drejtuar Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, një vërtetim të sindikatës së pavarur

të metalistëve të Kosovës, Ekstrakt i proces verbalit të Këshillit të punëtorëve datë 20.10.2004.

Me datë 02 nëntor 2017, AKP-ja e dorëzoi kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e veta të cekura në mbrojtjen në ankesë. AKP-ja pohon se përveç që kërkesa është parashkruar, NSH-ja nuk ka kryer aktivitet ekonomik dhe në periudhën kontestuese paditësja nuk ka punuar për NSH-në, ndërsa kontrata e ofruar e punës, është mes paditëses dhe ndërmarrjes private e jo ndërmarrjes shoqërore.

Me datë 16 nëntor 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0707, e aprovon kërkesë padinë e paditëses si të bazuar, e obligon të paditurën ti paguaj paditëses shumën në emër të pagave të pa paguara prej 10.140,00 euro, me kamatë në lartësi prej 10%, dhe vendos që kjo pagesë të kryhet sipas nenit 40 par 1 nën paragrafi 1.6.1 dhe nenit 41 Shtojcës të Ligjit të AKP-së. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se në periudhën në të cilën paditësja i pretendon pagat, NSH-ja nuk ia ka paguar pagat, ndërsa paditësja në vazhdimësi i kishte kërkuar pagat e pa paguara sipas kontratës së punës, ndërsa e paditura e ka konfirmuar ekzistimin e këtij detyrimi. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se pavarësisht në Gjykatë nuk është dorëzuar ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN126-0136, datë 31.03.2015, me dorëzimin e padisë në Gjykatë, konsiderohet se paditësja e ka shfrytëzuar mundësinë e inicimit të procedurës për mbrojtjen e të drejtave të saja brenda afatit ligjor komfor nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se sipas parashtresës së AKP-së të datës 16.07.2014, rezulton se AKP-ja nuk e kontestonte Autoritetin dhe kompetencat e organeve drejtuese të NSH-së, mirëpo AKP-ja ka konfirmuar këtë autoriteti deri në datën e procedurës së likuidimit. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se Drejtori i NSH-së "Auto Prishtina" I S, ishte hartues dhe nënshkrues i listës së punëtorëve aktiv të cilët nuk kishin marrë paga sipas kontratës së punës e evidentuar me numër 4 datë 12.06.2014, dhe ky dokument konfirmon Autoritetin dhe kompetencat e organeve drejtuese në këtë raste Drejtorit të NSH-së. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se nuk është kontestuese se paditësja ishte e punësuar tek e paditura deri në ditën e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së, nuk është kontestuese se kishte kontratë pune të cilës i është

caktuar lartësia e pagës, ndërsa me listën e punëtorëve aktiv është vërtetuar se punëtorët nuk i kanë marrë pagat sipas kontratës së punës.

Me datë 21 dhjetor 2021, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përmes postës një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-0707 të datës 16 nëntor 2021, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar, ose lënda të kthehet në rishqyrtim. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike, ndërsa është i gabuar konstatimi i Gjykatës së Shkallës së I-rë lidhur me vlerësimin që është dhënë nga Autoriteti i Likuidimit për kërkesën e paditësit. Tutje AKP-ja konsideron se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar pasi që paditësja ka dështuar të ofroj prova në Gjykatë se këto paga i ka kërkuar brenda 3 viteve pranë ndonjë Gjykate kompetente. Tutje AKP-ja pohon se Gjykata ka ngatërruar çështje të rëndësishme faktike dhe rrjedhimisht edhe juridike dhe për pasoj ka bërë vlerësim të gabuar dhe ka marrë Aktgjykim të pa drejtë. AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën si të pa pranueshme sepse paditësi nuk ka arritur të provoj me fakte meritën e kërkesës së tij. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë i ka ngatërruar dy çështje që janë krejtësisht të ndryshme, afatin për dorëzimin e kërkesave në bazë të dëshmisë së interesit në procedurën e likuidimit që është afat për parashtrimin e kërkesave dhe afatin e dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë e që i referohet pagave të pa paguara (afati i parashkrimit) që është 3 vite në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuara. Të dy afatet janë të ndara dhe të dallueshme dhe secili kreditor i NSH-së duhet ti përmbush këto dy afate në mënyrë që të shqyrtohet kërkesa. Bashkë me këtë ankesë AKP-ja e dorëzon vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN126-0136 datë 31.03.2015, i cili i referohet kërkesës për paga të kërkuara nga ana e paditëses.

Me datë 04 maj 2022, paditësja e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj, ndërsa e mbështet

Aktgjykimin e ankimuar të shkallës së I-rë duke e konsideruar si të bazuar në ligj. Padiësja në këtë parashtresë pohon se pretendimet e AKP-së janë kontradiktore dhe nuk janë relevante për rastin. Padiësja ka kërkuar nga Kolegji i Apelit që të refuzohet ankesa si e pa bazuar, dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 21 dhjetor 2022, Kolegji i Apelit me Aktvendimin AC-I-21-0835, ankesën e të paditurës e aprovon si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së dhe lëndën e kthen në rigjykim në Shkallën e I-rë të DHPGJS-së tek gjyqtari përkatës. Kolegji i Apelit ka arsyetuar se Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja vetëm në procedurën ankimore e sjell vendimin PRN126-0136 datë 31.03.2015, i cili vendim i referohet kërkesës për paga të papaguara të cilat padiësja i pretendon ndaj NSH-së, për periudhën 30 shtator 2003 e deri në qershor 2014, në shumë prej 10.140,00 euro. Këtë vendim nuk e ka pasur Shkalla e I-rë në dosjen e saj. Në bazë të këtij vendimi vërehet se padiësja me datë 11 shtator 2014, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe ka kërkuar paga për periudhën 30 shtator 2003 e deri në qershor 2014, në shumë prej 10.140,00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të punës së Bashkuar. Duke marrë për bazë faktin se kërkesa është dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit me datë 11 shtator 2014, atëherë del që pagat nga muaji shtator 2011 e deri në muajin qershor 2014, nuk janë parashkruar, pasi që ende nuk ka kaluar afati 3 vite i parashkrimit, ndërsa pagat e tjera të periudhës së cekur janë parashkruar. Kolegji i Apelit vëren se padiësja në ankesën e saj në Shkallën e I-rë dhe me parashtresat e më vonshme të saj ka pohuar që vazhdimisht i ka kërkuar pagat prej NSH-së në periudhën e cekur mirëpo ato nuk janë paguar. Kolegji i Apelit vëren se asetet e NSH-së në vitin 2000, nga autoritetet e UNMI-ut ishin dhënë me qira një kompanie private. Padiësja nuk është e qartë nëse ka punuar në këtë kompani private që i kishte marrë asetet e NSH-së me qira, mirëpo AKP-ja pohon se kontrata e punës të cilën padiësja e ka sjellë në gjykatë nuk është nënshkruar nga autoritetet përgjegjëse të NSH-së, por nga menagjmenti i ndërmarrja private. Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë ka nxjerr konstatimin e gabuar që NSH-ja e paditur e ka pranuar borxhin dhe se AKP-ja nuk e ka kontestuar Autoritetin dhe kompetencat e menagjmentit të

NSH-së. Me këto konstatime nuk pajtohet Kolegji i Apelit për faktin që Lista e pagave e hartuar dhe e nënshkruar nga Drejtori i kontestuar i NSH-së, në kohën kur ka filluar procedura e likuidimit në vitin 2014 nuk mund të konsiderohet si pranim i pagave për periudhën që kishte kaluar. Për më tepër në mbrojtjen në ankesë AKP-ja menagjmentin e NSH-së e trajton si menagjment të vetë shpallur i cili ka për qëllim përfitime, në momentin që Bordi i AKP-së, ka marrë në shqyrtim vendosjen në likuidim të NSH-së. AKP-ja listën e pagave të pa paguara të hartuar nga Drejtori i NSH-së në vitin 2014, thjesht e quan si provë që ka vlerë vetëm deklarative, dhe nuk mund të shërbej asesi si provë për përfitimin e pagesës së pretenduar nga paditësja në kërkesën e saj. Me këto pohime AKP-ja në fakt e ka kontestuar jo vetëm legjitimitetin dhe autoritetin e menagjmentit të NSH-së, por e ka kontestuar edhe shumën e kërkesës të cilën paditësja e kërkon në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur. Rrjedhimisht duke marrë për bazë faktin që pagat e kërkuara nga muaji shtator 2011 e deri në qershor 2014, ende nuk janë parashkruar, e duke marrë për bazë edhe faktin që për këtë periudhë kohore nuk dihet cila mund të jetë shuma që paditësja mund ta kërkon në emër të pagave të pa paguara, e duke marrë parasysh edhe faktin që padia që nga fillimi nuk i kishte plotësuar kriteret e pranueshmërisë, pasi që paditësja kishte dështuar ta dërgoj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, që është kriter i pranueshmërisë në bazë të nenit 74.2 të LDHP-së, Kolegji i Apelit konstaton se në këtë çështje juridike nuk është vendosur drejtë, pasi që ende saktësisht nuk është vërtetuar as gjendja faktike. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë dhe në përgjigjen në padi ka pohuar se NSH-ja nuk ka punuar, nuk ka qenë funksionale ndërsa asetet e saj janë dhënë me qira dhe pohon po ashtu se paditësja nuk ka ofruar ndonjë shërbim pune për NSH-në. Të gjitha këto fakte të paraqitura nga AKP që konsiderohen si fakte të kontestuara duhet të vërtetohen në procedurën në vazhdim me prova që mund ti sjellin të dy palët në mbështetjet të pretendimeve të tyre.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, Zyra e Regjistrimit këtë lëndë e regjistron me numrin e ri C-IV-22-0465.

Me datë 04 korrik 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0465 e refuzon ankesën e paditëses si të pa bazuar dhe e vërteton vendimin e ankimuar

të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nga faktet e treguara nga ana e paditëses nuk del themelësia e kërkesëpadisë së saj, andaj ankesa nuk është e bazuar. Tutje Shkalla e I-rë e DHPGJS ka arsyetuar se në bazë të nenit 42 paragrafi 2 dhe 3 të LDHP-së, si dhe nenit 7 të LPK-së, barra e të provuarit për të vërtetuar faktet e paraqitura bie mbi paditësen, gjë që ajo ka dështuar ti argumentojë pretendimet e veta se ka qenë punëtore aktive e NSH-së. Tutje Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësja nuk ishte punëtore aktive e NSH-së, andaj janë përmbushur kushtet ligjore për të marrë Aktgjykim meritor ngase mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast ishte e panevojshme. Tutje Shkalla e I-rë konstaton se pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale të ofruara nga paditësja ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e saj nuk është e bazuar në ligj, andaj ankesa e saj është refuzuar dhe është vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 13 korrik 2023, paditësja përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-22-0465 të datës 04 korrik 2023, për shkak të vërtetimit jo të drejtë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet Aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo të aprovohet padia si e bazuar dhe të detyrohet e paditura t'ia paguajë paditëses borxhin në emër të pagave të pa paguara prej 10,140.00 euro, për periudhën tetor 2003 – qershor 2014, si dhe ka kërkuar interesin ligjor prej 10%. Për më tepër në ankesë paditësja ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar ka një kontradiktë të hapur ku në një paragraf Gjykata e pranon se paditësja ka qenë punonjëse tek e paditura, derisa në paragrafin tjetër konstaton se paditësja ka dështuar të prezantojë prova që dëshmojnë se paditësja ka qenë në periudhën kontestuese punëtore aktive e ndërmarrjes. Tutje paditësja pohon se ajo ka dorëzuar prova të mjaftuara, kontratën e punës, librezën e punës, listat e pagave të pa paguara si dhe prova tjera me të cilat vërtetohet se ishte punëtore aktive e NSH-së deri në ditën kur NSH-ja ia ka shkëputur kontratën e punës, për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të NSH-së. Paditësja pohon se pala e paditur nuk e ka kontestuar asnjëherë se paditësja nuk ka qenë punonjëse aktive e ndërmarrjes, duke pohuar



se në vendimin e ankimuar Autoriteti i Likuidimit nuk i referohet askund paditëses si punonjëse jo aktive, mirëpo kërkesën për paga e refuzon me arsyetimin se është parashkuar. Tutje paditësja pohon se fakti se ajo ka qenë punëtore aktive në NSH dëshmohet edhe me vendimin PRN126-0138 të datës 29.04.2015, me të cilin vendim Autoriteti i Likuidimit ia ka njohur paditëses të drejtën në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 565,04 euro, dhe në emër të tatimit që duhet paguar në shumë prej 59.71 euro. Tutje në ankesë paditësja pohon se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së në rigjykim fare nuk i ka marrë parasysh sugjerimet dhe rekomandimet e dhëna nga Kolegji i Apelit me Aktgjykimin e tij AC-I-21-0835 të datës 21.12.2022. Shkalla e I-rë në vend të kësaj ka vendosur ta refuzojë kërkesëpadinë në mungesë të provave duke dhënë një rezultat krejt ndryshe nga Aktgjykimi i parë i anuluar C-IV-15-0707 të datës 16.11.2021, me të cilin ishte aprovuar padia si e bazuar. Ky kontradiktoritet shkakton pasiguri juridike për paditësen dhe me Aktgjykimin e ankimuar janë anashkuar të gjitha provat materiale që i kishte paraqitur paditësi në mbështetje të ankesës. Bashkë me këtë ankesë ajo ka bashkangjitur një vendim të një punëtori tjetër që i përket një kompanie aksionare ndërtimore, "Ramiz Sadiku" Prishtinë.

Me datë 04 shtator 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës së paditëses. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditëses si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditëses është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesave dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se me Aktvendimin e tij të datës 21 dhjetor 2022, AC-I-21-0835, me të cilën lënda ishte kthyer në rigjykim, pos tjerash kishte konstatuar se kërkesa e paditëses për pagat e kërkuara prej NSH-së për periudhën shtator 2011 e deri në muajin qershor 2014, nuk është parashkruar siç pretendon AKP-ja me mbrojtjen në ankesë dhe në parashtresat e mëposhtme, duke marrë për bazë faktin se kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit ishte dorëzuar me datë 11 shtator 2014. Kolegji i Apelit në Aktvendimin e cekur kishte konstatuar se pagat e kërkuara për periudhën e mëhershme janë parashkruar. Tutje Kolegji i Apelit në Aktvendimin e cekur i kishte dhënë disa rekomandime Shkallës së I-rë të DHPGJS-së që ti vërtetojë disa fakte që ishin kontestuese mes palëve, dhe jo të mbështetura mjaftueshëm me prova.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së pas kthimit të lëndës në rigjykim në bazë të shkresave të dosjes nuk shihet që ka marrë ndonjë veprim procedural siç ishte rekomanduar nga Kolegji i Apelit, dhe po ashtu nuk ka mbajtur asnjë seancë dëgjimore, duke konstatuar se seanca ishte e panevojshme. Këto rekomandime dhe udhëzime të Kolegjit të Apelit, tërësisht janë injoruar nga shkalla e I-rë, megjithëse ato në bazë të nenit 199 të LPK-së, janë të detyrueshme për shkallën e I-rë, dhe shkalla e I-rë ishte e detyruar ti përfill këto kërkesa të Kolegjit të Apelit.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se paditësja me provat e ofruara nuk ka dëshmuar se ka qenë punëtore aktive e NSH-së.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet këtë konstatim të gabuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së. Paditësja ka sjellur njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës,

ka sjellë Librezën e punës e cila është hapur, dhe po ashtu ka sjellë edhe vendimin, PRN126-0138 të datës 29.04.2015, në bazë të cilit vendim Autoriteti i Likuidimit ia ka njohur paditëses të drejtën në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 565.04 euro, si dhe Listën e punëtorëve aktiv të cilët nuk i kanë marrë pagat sipas kontratës, Nr.pr... të datës..... Me gjithat këto prova ende nuk janë të mjaftueshme, për të njohur të drejtën në paga për periudhën që nuk është parashkruar, pasi nuk ka prova se në këtë periudhë paditësja a ka punuar për NSH-në apo kompaninë private, që i kishte marrë asetet e saj me qira.

Për më tepër në mbrojtjen në ankesë AKP-ja, menagjmentin e NSH-së e trajton si menagjment të vetë shpallur i cili ka për qëllim përfitime, në momentin që Bordi i AKP-së, ka marrë në shqyrtim vendosjen në likuidim të NSH-së. AKP-ja listën e pagave të pa paguara të hartuar nga Drejtori i NSH-së në vitin 2014, thjesht e quan si provë që ka vlerë vetëm deklarative, dhe nuk mund të shërbej asesi si provë për përfitimin e pagesës së pretenduar nga paditësja në kërkesën e saj. Me këto pohime AKP-ja në fakt e ka kontestuar jo vetëm legjitimitetin dhe autoritetin e menagjmentit të NSH-së, por e ka kontestuar edhe shumën e kërkesës të cilën paditësja e kërkon në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur.

Kolegji i Apelit konstaton se në këtë çështje juridike nuk është vendosur drejtë, pasi që ende saktësisht nuk është vërtetuar as gjendja faktike. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë dhe në përgjigjen në padi ka pohuar se NSH-ja nuk ka punuar, nuk ka qenë funksionale ndërsa asetet e saj janë dhënë me qira dhe pohon po ashtu se paditësja nuk ka ofruar ndonjë shërbim pune për NSH-në. Paditësja në anën tjetër ka pretendime tjera krejt të kundërta. Të gjitha këto fakte të paraqitura nga AKP dhe nga paditësja që konsiderohen si fakte të kontestuara, duhet të vërtetohen në procedurën në vazhdim me prova që mund ti sjellin të dy palët në mbështetjet të pretendimeve të tyre.

Andaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e aprovon ankesën e paditëses si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën e kthen edhe njëherë në rigjykim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së. Shkalla e I-rë në kuptim të nenit 199 të LPK-së është

e obliguar ti përfillë vërejtjet e shkallës së dytë, të mbaj një seancë dëgjimore, ti vërtetoj faktet kontestuese, dhe pastaj të merre një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Prandaj nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

### **Taksat gjyqësore**

Paditësja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 31 korrik 2023, në shumë prej 30 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendosë nga Kolegji i Apelit me 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_